



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 maj 2023
Nr. Ref.:RK 2190/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI53/22

Parashtrues

Basri Sejdiu dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Statutit për Plotësim
Ndryshimin e Statutit të Qendrës Klinike Universitare, i 8 prillit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga Basri Sejdiu, Xhevdet Krasniqi, Aurora Bakalli, Luljeta Durmishi, Daut Gorani, Violeta Kamberi, Fisnik Veliu, Artan Krasniqi, Jetmir Sejdiu, Denis Zijabeg, Lulzim Bashota, Taulant Sadriu, dhe Luan Keka, që të gjithë mjekë në kuadër të repartit të Kardiologjisë Invazive, të përfaqësuar nga Florim H. Shefqeti, avokat nga Prishtina (Në tekstin në vijim: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Statutit për Plotësim Ndryshimin e Statutit të Qendrës Klinike Universitare (Në tekstin në vijim: Akti i kontestuar), të 8 prillit 2022, të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë.
3. Akti i kontestuar u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 13 prill 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 46 [Mbrojtja e Pronës], 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E Drejta për zgjidhje efektive), neni 1.1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit shtesë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin në vijim: KEDNJ), dhe nenit 1 (Qëllimi), 2 (Fushëveprimi) dhe 4 (Llojet e trajtimit të pabarabartë) të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.
5. Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës kërkojnë edhe vendosjen e masës së përkohshme ndaj efekteve juridike të aktit të kontestuar, si dhe mbajtjen e seancës dëgjimore.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 26 prill 2022, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 6 maj 2022, Kryetarja përmes Vendimit [Nr.GJR.KI53/22] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe përmes Vendimit [Nr.KSH.KI53.22] caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
9. Më 12 maj 2022, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi (i) plotësimin e formularit të Gjykatës; dhe (ii) dorëzimin e autorizimit për përfaqësim në Gjykatë.
10. Më 10 qershor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi plotësimet e kërkuara.
11. Më 12 shtator 2022, Gjykata njoftoi Ministrinë e Shëndetësisë për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtës i ofroi një kopje të saj.

12. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes se Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 12 prill 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesit e kërkesës aktualisht janë mjekë të cilët punojnë në kuadër të Repartit të Kardiologjisë Invazive të Qendrës Klinike dhe Universitare (Në tekstin në vijim: QKU). Në bazë të shkresave të lëndës, dhe bazuar në theksimet e parashtruesve *“Reparti i Kardiologjisë Invasive, aktualisht funksionon bashkë me Njësinë e Kardiokirurgjisë, njësi këto të ndërlidhura ngushtë në aspektin profesional”*.
15. Sipas shkresave të lëndës *“Bordi i ShSKUK-së ka dorëzuar një Statut duke kërkuar “Plotësim Ndryshimin e Statutit të QKUK-së”. Ne këtë statut, është propozuar shfuqizimi i Vendimit nr. 141/16 i dt. 14.11.2016, me nr. protokollit 05-7597, lidhur me nenin 12 nën paragrafi 6.17, i Statutit të QKUK-së. Kështu ka përcaktuar që Kardiologjia Invasive të kthehet në Klinikën e Kardiologjisë dhe të ndahet nga Kardiokirurgjia”*.
16. Nga shkresat e lëndës rezulton se me 8 prill 2022, Ministria e Shëndetësisë miratoi Statutin për Plotësim dhe Ndryshimin e Statutit të Qendrës Klinike Universitare (aktin e kontestuar), e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 13 prill 2022.
17. Statuti për Plotësim dhe Ndryshimin e Statutit të Qendrës Klinike Universitare (akti i kontestuar), ishte nxjerrë nga Ministri i Shëndetësisë me propozim të Bordit të SHSKUK-së, në bazë të Nenit 14 të Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi, si dhe duke u bazuar në nenin 8 të Rregullores Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Ky Statut ka 4 nene të cilat përcaktojnë: Neni 1 [Qëllimi] përcakton qëllimin e ndryshimit të nenit 12 të Statutit të Qendrës klinike universitare; Neni 2 përcakton që plotësohet dhe ndryshohet nënparagrafi 6.17 i nenit 12 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare i miratuar në maj të vitit 2014, si në vijim: 6.17. Shërbimi klinik i Kardiokirurgjisë. Neni 3 (Shfuqizimi) shfuqizohet Vendimi nr. 141/16 i 14 nëntorit 2016, me numër protokollit [05-7597], lidhur me nenin 12 nën paragrafi 6.17, i Statutit të QKUK-së. Neni 4 (hyrja në fuqi) përcakton që ky Statut hyn në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
18. Rrjedhimisht, me plotësim-ndryshimin e këtij statuti, Shërbimi Kardiologjik Invaziv është rikthyer në kuadër të Klinikës së Kardiologjisë, pasi i njëjti ishte zhvendosur në Klinikën e Kardiokirurgjisë në vitin 2016.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

19. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se janë *“të dëmtuar nga veprimet e pretenduara si kunderligjore”*. Specifikisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me nxjerrjen e aktit të kontestuar u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të pjesëmarrjes], 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor], 46 [Mbrojtja e Pronës], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces

të rregullt) dhe 13 (E Drejta për zgjidhje efektive), neni 1.1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit shtesë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin në vijim: KEDNJ), dhe nenit 1 (Qëllimi), 2 (Fushëveprimi) dhe 4 (Llojet e trajtimit të pabarabartë) të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

20. Parashtruesit e kërkesës fillimisht theksojnë se për këtë Statut, mjekët e Kardiologjisë Invazive, fare nuk ishin konsultuar dhe në këtë mënyrë, të njëjtit konsiderojnë që kjo formë e procedimit është kundërligjore dhe përben shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre.
21. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se mospajtimet e tyre i kishin paraqitur edhe në Bordin e SHSKUK-së, pasi që *“paraqitëseve të kësaj kërkesë u mohohet e drejta për të konkurruar në pozita menaxhuese (shefa repartesh, e deri tek drejtori), kjo duke qenë se vet nën vënia në ombrellën e një subjekti tjetër, e në të cilin kanë përfunduar procedurat e zgjedhjeve, del të jetë kundër kushtetuese dhe që bënë mohimin e të drejtës së zgjedhjes”*.
22. Në vijim parashtruesit e kërkesës theksojnë që kjo formë e të vepruarit është *“kundër raportit me rekomandime për Asistencën Teknike, në menaxhimin spitalor të SHSKUK - QKUK, shkurt 2020, përpiluar nga I-C-M-E Healthcare, e kontraktuar dhe paguar nga Qeveria e Kosovës”* (Sqarim: ky dokument është dorëzuar nga parashtruesit dhe është pjesë e dosjes në këtë rast). Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë se forma e organizimit të repartit (para nxjerrjes së aktit të kontestuar) *“ishte bere edhe me investime nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e tëra mbi bazë të vlerësimit nga J.-C-M-E Healthcare, prandaj veprimet ndryshe nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, paraqesin edhe cenim të vlerësimit të dhënë nga rekomandimet e përmendura më lartë”*.
23. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me nxjerrjen e aktit të kontestuar atyre u janë shkelur të: (i) drejtat e tyre kushtetuese, respektivisht nenet: 3, 31, 32, 45, 46, 52, 54, të Kushtetutës në lidhje me lidhje me nenin 6 dhe 13, neni 1.1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit shtesë të KEDNJ-së; (ii) të drejtat e garantuara nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, respektivisht nenit 1, paragrafi 1.1. 1.14 dhe 1.16 dhe neni 2. Parashtruesit, gjithashtu ngrisin pretendime (ii) sa i përket formës, përmbajtjes edhe procedurës së hartimit të aktit të kontestuar, dhe (iii) pretendimet përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës.
24. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës do të paraqiten në vijim sipas kronologjisë së paraqitur nga parashtruesit e kërkesës.

Pretendimet për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë

25. Në kuadër të pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës thirren në përmbajtjen dhe garancitë e nenit 31 si dhe referohen në disa raste të GJEDNJ-së si në vijim: *Hornsby kundër Greqisë, Z kundër Mbretërisë së Bashkuar, Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar Imobiliare Saffi kundër Italisë*.
26. Në vijim parashtruesit e kërkesës e përmendin edhe rastin e Gjykatës KO145/21, me parashtrues Komuna e Kamenicës.
27. Për sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative dhe se kjo e drejtë iu është garantuar edhe me KEDNJ.

28. Parashtruesit tutje theksojnë "po ashtu neni 25 [Sqarim: parashtruesit i referohen nenit 25, mirëpo ne përmbajtje kane pretendime për nenin 45] përcakton te drejtën për te zgjedhe dhe për te u zgjedhur, e qe ne rastin konkret kjo e drejte iu është mohuar sepse ne konkursin për zgjedhjen e drejtorit të Kardiologjisë nuk kanë pasur të drejtë të kandidojnë tani paraqitësit e kësaj kërkesë".
29. Për sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë që të njëjtit kanë pritje legjitime, pasi sipas tyre "Në rast konkret, paraqitësit e kërkesës kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë pritje legjitime në lidhje me procedimin e "Kërkesës së tyre", meqë në rrethanat e rastit e drejta e paraqitësve dhe interesat e tyre mbi nxjerrjen e një akti juridik nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, paraqesin një vlerë (asset) e cila sipas praktikës së GJEDNJ-së konsiderohet si e "drejtë pronësore".
30. Parashtruesit e kërkesës për sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 52 të Kushtetutës theksojnë: "E drejta për qasje, nga neni 52 par 3, citoj: "Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysht nga institucionet publike ne procesin e marrjes se vendimeve".
31. Në ndërlidhje me pretendimet për shkelje të nenit 54 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se "Kushtetuta në mënyrë primare e garanton mbrojtjen në Gjykatë, si formën më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në të drejtën e brendshme". Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës theksojnë se "neni 54 i Kushtetutës përmban dispozitën e cila ia garanton çdo individit edhe të drejtën për masa efikase juridike, nëse konstatohet se e drejta i është shkelur."
32. Në fund, parashtruesit i referohen përmbajtjes se nenit 3 par 2, si dhe nenit 52, por nuk theksojnë ndonjë pretendim në lidhje me këto dy nene kushtetuese.

Pretendimet për shkelje të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi

33. Duke u referuar në përcaktimin e nenit 2 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtruesit theksojnë se: "(i) SHSKUK dhe MSH është dashur dhe janë të obliguar që të veprojnë sipas kërkesave ligjore; se (ii) lloji të trajtimit, diskriminimi i bërë nga Ministria e Shëndetësisë, mund të kualifikohet si "Diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë të nenit 4 paragrafi. 1, pika 1 i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me diskriminim të tërthortë, përcaktuar në pikën 1.2."
34. Sipas parashtruesve të kërkesës "Duke qenë se Ministria e Shëndetësisë ka vepruar në këtë mënyrë, ka avancuar dhe u ka dhënë përparësi në gradime pjesëtarëve të tjerë, duke diskriminuar në mënyrë të drejtpërdrejtë Paraqitësit e Kërkesës dhe duke i trajtuar në situatë të krahasueshme në mënyrë më pak të favorshme sesa janë trajtuar pjesëtarët tjerë, si dhe duke u pamundësuar të njëjtëve kushte të barabarta në procesin e zhvillimit në karrierë dhe gradimit në kuptim të nenit 1, paragrafi 1.1. l.14 dhe 1.16 i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi të elaboruara më sipër që ka për qëllim apo efekt të zhuleftësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës."

Parashtruesit kanë pretendime edhe sa i përket formës, përmbajtjes edhe procedurës së hartimit të aktit të kontestuar.

35. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës kontestojnë (i) emërtimin, respektivisht sipas tyre “në aspektin juridik, statuti nuk mund të plotësohet me akt tjetër të quajtur statut, kjo mund të bëhet vetëm nëse nxirret/ aprovohet një statut i ri, e që në këtë rast as nga përmbajtja e këtij dokumenti, nuk është bërë nxjerrja e statudit të ri”; (ii) se përmbajtja e preambulës është kundërligjore; (iii) se ky dokument, ka pretenduar ndryshimin apo plotësimin e statudit të vitit 2014 por si i tillë nuk ka respektuar formën, përmbajtjen dhe procedurën ligjore; se (iv) nuk është bërë ndryshimi i asnjë paragrafi, dhe rrjedhimisht çdo ndryshim të tentuar e bën të kundërligjshëm, (v) dhe se kjo dispozitë rregullon shërbimin klinik të kardiokirurgjisë edhe kardiologjisë invazive dhe kjo mënyrë e vendosjes ka cenuar aplikimin e po këtij statuti neni 12 par 7, i cili në mënyrë decisive kërkon që të behet respektimi i ligjit dhe akteve të tjera nënligjore, që në rastin konkret nuk janë respektuar; se (vi) Propozimi nga Bordi i QKUK del të jetë kundër statudit neni 22 ngase askund nuk i jepet kompetenca Bordit që të bëjë propozime se ka kërkuar për aktin e atakuar përmes kësaj kërkesë për anulim”.
36. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës theksojnë se procedura për nxjerrjen e aktit të kontestuar është në kundërshtim dhe në shkelje të: Rregullores nr. 09/2011 të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit Publik; dhe Udhëzimit Administrativ për Standardet e Hartimit të Akteve Normative.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkritazi me pranueshmërinë e kërkesës

37. Parashtruesit fillimisht duke iu referuar neni 1, dhe neni 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative theksojnë se me këtë “ligji rregullohen kompetenca, përbërja e gjykatës dhe rregullat e procedurës” dhe “që paraqitësit e kësaj kërkesë, nuk iu është e lejueshme mundësia e ankimit efektiv në Gjykatë Themelore, Departamentin për çështje Administrative”.
38. Parashtruesit e kërkesës theksojnë që “Meqenëse nuk kanë qenë palë në procedurën kur janë cenuar të drejtat e parashtruesve nuk kanë pasur mjete juridike në dispozicion me të cilat do të atakonin vendimet e Gjykatës Supreme dhe po ashtu Legjislacioni në dispozicion nuk e rregullon me ndonjë normë këtë çështje.”
39. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se përderisa nuk kanë pasur në dispozicion mjete juridike për të atakuar vendimet në gjykata të rregullta, të njëjtit kërkojnë nga Gjykata që të konstatojë që “parashtruesit e kësaj kërkesë kanë shterur mjete juridike dhe të vlerësojë shkeljen e të drejtave dhe lirive të tyre, me këtë kërkesë për vlerësim të ligjshmërisë.”
40. Për sa i përket aspektit të shterjes së mjeteve juridike, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata të ketë parasysh praktikën e GJEDNJ-së, e cila kërkon që aplikimi i rregullës të bëhet me fleksibilitet dhe pa shumë formalitet si në rastin *Kenneth Lehtinen kundër Finlandës*. Parashtruesit gjithashtu referohen edhe në rastet *Van Oostereijck kundër Belgjikës* dhe *D.H et al kundër Republikës Çeke*.
41. Në vijim parashtruesit e kërkesës, në kontekst të lirimit nga aspekti i shterimit të mjeteve juridike përmendin edhe rastet përkatëse të Gjykatës: rasti KI56/09, me parashtrues *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit*, rastin KI 34/17, me parashtruese *Valdete Daka*, dhe rasti KI100/14.

42. Parashtruesit e kërkesës lidhur me kërkesën e tyre theksojnë se Akti i kontestuar konsiderohet Akt i Ministrisë së Shëndetësisë dhe i plotëson kushtet për t'u konsideruar i tillë, pasi që i njëjti shkel në mënyrë të drejtpërdrejtë kompetencat që kanë paraqitësit, përfshirë të drejtat e tyre. Parashtruesit në lidhje me këtë pretendim i referohen rastit të Gjykatës KO145/21, për të cilin konsiderojnë që është rast analog me rastin e tyre.

Kërkesa për masë të përkohshme

43. Parashtruesit e kërkesës fillimisht *“propozojnë caktimin e masës së përkohshme ndaj efekteve juridike të Statutit të SHSKUK-së të Qendrës Klinike Universitare, të datës 08.04.2022.”*
44. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se *“caktimi i masës së përkohshme është i rëndësishëm sepse përveç cenimit të interesave private të tyre, këto interesa që lidhen me punën e tyre dhe të drejtën e tyre për të u zgjedhur, efekti i dëmshëm i këtij statuti shtrihet edhe në ndikimin publik duke qenë se ky statut cenon edhe interesat publike të cilat lidhen me ofrimin e shërbimeve mjekësore për qytetarë.”*
45. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që (I) të deklarojë kërkesën si të pranueshme dhe të njëjtën ta aprovojë; (II) të caktojë masën e sigurisë të propozuar nga parashtruesi i kërkesës; (III) të konstatojë se ka shkelje të të drejtave kushtetuese të parapara në dispozitat e neneve 31, 32, 45, 46, 52, dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe dispozitave të neneve 6, 13 dhe neni 1.1 të Protokollit shtesë i KEDNJ-së; dhe shkelje të nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen nga diskriminimi; (IV) të shpallë kundërkushtetues dhe pa efekt juridik Statutin për Plotësim Ndryshimin e Statutit të Qendrës Klinike Universitare datë 08.04.2022, i Aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë.
46. Parashtruesit e kërkesës përfundimisht theksojnë *“Kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese që të na ftojë në seancë për trajtimin meritor të rastit”.*

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 54
[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

LIGJI NR. 03/L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera, të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me vendime individuale ose me veprimet e organeve të administratës publike.

Neni 10
[pa titull]

1. Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor.

*2. Organi i administratës, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike mund të fillojnë konfliktin administrativ.
[...]*

Neni 13
Konflikti administrativ

1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.

2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.

Neni 18
[pa titull]

Paditës në konfliktin administrativ mund të jetë personi fizik, personi juridik, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesit publik, që konsideron se me aktin administrativ i është shkelur ndonjë e drejtë apo ndonjë interes i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i bazuar në ligj.

Neni 63

Dispozita të tjera të procedurës

Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshëmrisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore.

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

KTHIMI NE GJENDJEN E MËPARSHME

Neni 129 (Pa titull)

129.1 Ne qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen.

129.2 Kur lejohet kthimi në gjendje të mëparshme procesi kontestimor kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para mosveprimit dhe prishen të gjitha vendimet që i ka dhënë gjykata për shkak të mosveprimit.

Neni 130 (Pa titull)

130.1 Propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme i paraqitet gjykatës në të cilën është dashur të kryhet veprimi procedural i pakryer.

130.2 Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkak i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin.

130.3 Pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme.

130.4 Po që se kthimi në gjendje të mëparshme kërkohet për shkak të mos ruajtjes së afatit për kryerjen e veprimit procedural, propozuesi ka për detyrë që propozimit t'ia bashkëngjisë veprimin e shkruar procedural të pakryer me kohë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

47. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
48. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

49. Bazuar në këtë dispozitë kushtetuese, janë dy kriteret themelore që e përcaktojnë pranueshmërinë e një kërkesë, përkatësisht (i) që kërkesa të jetë parashtruar nga një individ i cili është i autorizuar për të ngritur shkelje të pretenduara nga autoritetet publike të drejtave individuale; dhe (ii) që një kërkesë e tillë, mund të parashtrohet në Gjykatën Kushtetuese, vetëm pasi të jetë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë përmbushjen e këtyre dy kriterëve, duke u bazuar edhe në dispozitat e Ligjit dhe Rregullores së punës.

Për sa i përket palës së autorizuar

50. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vë në pah se parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tyre individuale të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], 46 [Mbrojtja e Pronës], 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E Drejta për zgjidhje efektive), neni 1.1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit shtesë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin në vijim: KEDNJ), dhe nenit 1 (Qëllimi), 2 (Fushëveprimi) dhe 4 (Llojet e trajtimit të pabarabartë) të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.
51. Lidhur me kushtin e parë, përkatësisht për palën e cila ka të drejtë në parashtrimin e kërkesës Gjykata thekson se parashtruesit e kërkesës janë të autorizuar të paraqesin kërkesë kushtetuese pranë Gjykatës, bazuar në nenin 113 paragrafi 7 i Kushtetutës, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik (shih rastin e Gjykatës [KI10/22](#), me parashtrues *Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore*, Aktgjykim i 15 gushtit 2022, paragrafët 46-47).
52. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar të cilët konteston një akt të një autoriteti publik.

Për sa i përket shterimit të mjeteve juridike

53. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

*Neni 47
[Kërkesa individuale]*

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

54. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, që specifikon:
“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.”

55. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë nëse parashtuesi i kërkesës ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike, siç përcaktohet përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës.
56. Gjykata rikujton se në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, parashtuesit e kërkesës theksojnë se nuk e kanë të lejuar mundësinë e ankimit efektiv në Gjykatë Themelore. Prandaj, parashtuesit e kërkesës pretendojnë se përderisa nuk kanë pasur në dispozicion mjete juridike për të atakuar vendimet në gjykata të rregullta, të njëjtit kërkojnë nga Gjykata që të konstatojë që *“parashtruesit e kësaj kërkesë kanë shterur mjete juridike dhe të vlerësojë shkeljen e të drejtave dhe lirive të tyre, me këtë kërkesë për vlerësim të ligjshmërisë.”*
57. Marrë parasysh pretendimin, përkatësisht kërkesën e parashtueseve të kërkesës për t’u liruar nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike, përkatësisht, në rrethanat e rastit konkret, *“padisë për konflikt administrativ”* si mjet juridik i përcaktuar me ligj, Gjykata në vijim do të paraqesë: (i) parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për sa i takon shterimit të mjeteve juridike; (ii) parimet e shtjelluara përmes opinionëve dhe raporteve të Komisionit të Venecias, të cilat, ndër tjerash, reflektojnë edhe analiza krahasimore lidhur me kriterin e shterimit të mjeteve juridike, si një ndër kriteret e pranueshmërisë në shqyrtimin e kërkesave para gjykatave kushtetuese të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës; dhe më pas (iii) do t’i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.
58. Parimet e lartcekura dhe më pas aplikimi i tyre, do të paraqiten në mënyrë që Gjykata të vlerësojë, nëse në rrethanat e rastit konkret, parashtuesit e kërkesës do të mund të liroheshin nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike, kërkesë kjo e përcaktuar përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata duke u bazuar në parimet e përgjithshme, duke përfshirë praktikën e saj të mëhershme gjyqësore dhe parimet e Komisionit të Venecias, duhet të vlerësojë nëse (i) mjetet juridike të cilat parashtuesit e kërkesës nuk i kanë shteruar, nuk janë *“mjaftueshëm të sigurta jo vetëm në teori, por edhe në praktikë”* sepse të njëjtat nuk mund *“të ofrojnë zgjidhje përkitazi me pretendimet e një parashtuesi”* dhe *“të ofrojnë një mundësi të arsyeshme për sukses”*; dhe (ii) nuk janë në *“dispozicion, të qasshme dhe efektive”*. Për më tepër, Gjykata, bazuar në të njëjtën praktikë gjyqësore, gjithashtu duhet të vlerësojë nëse parashtuesit e kërkesës *“kanë bërë gjithçka që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme nga ata që të shterojnë mjetet juridike”*, duke marrë parasysh gjithashtu se *“dyshimet e thjeshta”* e një parashtuesi rreth joefikasitetit të një mjeti juridik, nuk vlejnë si arsye për ta liruar një parashtues nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike të përcaktuar me Kushtetutë.

I. Parimet e përgjithshme përkitazi me shterimin e mjeteve juridike

(i) Parimet e përgjithshme në lidhje me shterimin e mjeteve juridike sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës

59. Kushtet për të vlerësuar nëse është përmbushur detyrimi për të shteruar të gjitha mjetet juridike *“efektive”* janë përcaktuar mirë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për

të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në pajtim me të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore, të garantuara me Kushtetutë. Të njëjtat parime janë shtjelluar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet [KI57/22 dhe KI79/22](#), parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, Aktvendim për papranueshmëri i 4 korrikut 2022, paragrafi 88; [KI147/18](#), parashtrues *Arbër Hadri*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 tetorit 2019; [KI211/19](#), parashtrues *Hashim Gashi, Selajdin Isufi, B.K., H.Z., M.H., R.S., R.E., S.O., S.H., H.I., N.S., S.I., dhe S.R.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020; [KI43/20](#), parashtruese *Fitore Sadikaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 gushtit 2020; [KI42/20](#), parashtrues *Armend Hamiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 gushtit 2020; dhe [KI09/21](#), parashtrues *Sadat Lekiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021.

60. Siç është sqaruar përmes praktikës gjyqësore, bazuar në parimin e subsidiaritetit, qëllimi dhe arsyetimi i detyrimit për të shteruar mjetet juridike ose rregulli i shterimit, është t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ai bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 të Kushtetutës dhe në nenin 13 të KEDNJ-së, se rendi juridik i Republikës së Kosovës siguron mjete efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së *Ëeis kundër Sllovenisë*, nr. [37169/03](#), Vendim i 14 shkurtit 2012; dhe *Aksoy kundër Turqisë*, nr. 21987/93, Aktgjykimi i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51 dhe [KI57/22 dhe KI79/22](#), parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, cituar më lart, paragrafi 70).
61. Gjykata në vazhdimësi e respekton parimin e subsidiaritetit, duke konsideruar se të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat para gjykatave të rregullta, me qëllim që të parandalojnë shkeljen e Kushtetutës ose, nëse ka, të korigjojnë shkeljen e tillë të një të drejte themelore të garantuar me Kushtetutë. Gjykata po ashtu ka pohuar në vazhdimësi se parashtruesit e kërkesës janë përgjegjës kur rastet e tyre përkatëse shpallen të papranueshme nga Gjykata, nëse nuk kanë shfrytëzuar procedurën e rregullt ose nuk kanë raportuar shkelje të Kushtetutës në procedurat e rregullta (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: [KI57/22 dhe KI79/22](#), parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, cituar më lart, paragrafi 71; [KI89/15](#), parashtrues *Fatmir Koci*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 marsit 2016, paragrafi 35; dhe shih, gjithashtu, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë*, nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, Aktgjykim i 25 marsit 2014, paragrafi 70).
62. Bazuar në të njëjtën praktikë gjyqësore, lirimi nga detyrimi për të shteruar mjetet juridike, bëhet vetëm përjashtimisht dhe vetëm në raste specifike me rastin e analizimit të këtij kriteri të pranueshmërisë në dritën e rrethanave faktike, juridike dhe praktike të një rasti konkret (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës në të cilat është aplikuar një përjashtim i tillë: [KI56/09](#), parashtrues *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2010, paragrafët 44-46; [KI06/10](#), parashtrues *Valon Bislimi*, Aktgjykim i 30 tetorit 2010, paragrafët 50-56 dhe paragrafi 60; [KI41/12](#), parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim i 25 janarit 2013, paragrafët 64-74; [KI99/14 dhe KI100/14](#), cituar më lart, paragrafët 47-50; [KI34/17](#), parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 68-73; dhe [KI55/17](#), parashtruese *Tonka Berisha*, Aktgjykim i 5 korrikut 2017, paragrafët 53-58).
63. Në parim, rregulli i shterimit duhet të zbatohet me një “*shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar*”, duke pasur parasysh kontekstin e mbrojtjes së të drejtave dhe

lirive themelore të njeriut. Në këtë drejtim, GJEDNJ gjithashtu ka përvetësuar konceptin e “*rrethanave të veçanta*”, përmes të cilit e bënë vlerësimin, nëse në rastin konkret ka ndonjë bazë të veçantë që e liron parashtruesin përkatës nga përmëshja e detyrimit të shterjes së mjetit juridik. Megjithatë, në të gjitha rastet e bazuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së, në vlerësimin nëse janë shteruar mjetet relevante juridike apo nuk janë “*efektive*”, zbatohet testi i “*barrës së të provuarit*”, proces ky i përcaktuar qartë në praktikën e saj gjyqësore dhe në bazë të të cilit, në parim, parashtruesi përkatës i kërkesës duhet të deklarojë se i ka shteruar mjetet juridike apo se ato nuk kanë qenë “*efektive*” në rrethanat e rastit përkatës (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KI57/22](#) dhe [KI79/22](#), parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, cituar më lart, paragrafi 69; [KI09/21](#), parashtrues *Sadat Lekiqi*, cituar më lart; [KI43/20](#), parashtruese *Fitore Sadikaj*, cituar më lart; [KI42/20](#), parashtrues *Armend Hamiti*, cituar më lart; [KI211/19](#), parashtrues *Hashim Gashi, Selajdin Isufi, B.K., H.Z., M.H., R.S., R.E., S.O., S.H., H.I., N.S., S.I., dhe S.R.*, cituar më lart, paragrafët 56, 59 dhe 60 dhe referencat e përdorura aty).

(i) *Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese*

64. Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore në rastet kur është kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve apo njoftimeve përkatëse lidhur me përzgjedhjet apo emërimet për pozita të ndryshme në institucione në sistemin e drejtësisë dhe jo vetëm, praktikë kjo e cila do të shtjellohet në vijim. Gjykata në këtë kontekst, thekson që përgjatë gjithë praktikës së saj gjyqësore, ka pasur vetëm tri përjashtime në këtë kontekst dhe ku ka konsideruar se nuk ka nevojë që të shterohen mjetet juridike.

(a) *Rastet ku Gjykata ka vendosur për papranueshmëri për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike*

65. Gjykata fillimisht thekson se, përmes praktikës së saj gjyqësore në vlerësimin e akteve të autoriteteve publike bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar pranueshmërinë e kërkesave të individëve e të cilat kanë pretenduar shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me Kushtetutë si rezultat i dështimit për tu zgjedhur dhe/ose emëruar në funksione publike nga institucionet e Republikës përfshirë akte të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv. Të gjitha këto kërkesa janë shpallur të papranueshme si pasojë e mosshterimit të mjeteve juridike (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KI09/21](#), parashtrues *Sadat Lekiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 prillit 2021). Duke marrë parasysh rrethanat e rastit konkret, përkatësisht kontestimin e Vendimeve të KPK-së, Gjykata në vijim do të paraqes vetëm praktikën e saj gjyqësore në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së rasteve kur janë kontestuar akte të Këshillit Prokurorial dhe/ose atij Gjyqësor, përkatësisht [KI114/10](#); [KI139/11](#); [KI130/12](#); [KI145/15](#); [KI42/20](#); [KI43/20](#); dhe [KI164/20](#). Të gjitha këto raste, janë Aktvendime për Papranueshmëri, për shkak se nuk ishin shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Ekzistojnë vetëm tri përjashtime në kontekst të vlerësimit të akteve të KPK-së dhe KGJK-së, pa u përmëshur ky kriter kushtetues dhe të cilat Gjykata do t'i sqarojë përgjatë këtij Aktvendimi. Megjithatë, fillimisht, në vijim do të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e Aktvendimeve të lartcekura për Papranueshmëri.

66. Fillimisht, Gjykata rikujton rastin [KI114/10](#) në të cilin parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë të Njoftimit [Nr. 01/118-713] të 27 tetorit 2010 të KGJK-së për riemërimin e gjyqtareve dhe prokurorëve, në të cilin parashtruesja e kërkesës ishte njoftuar se bazuar në nenin 150 [Procesi i Emërimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve] të Kushtetutës, mandati i saj pushon si pasojë e procesit të riemërimit përgjatë fazës së tretë

të riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në nenet përkatëse të Urdhëresës Administrative nr.2008/02 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemimin e drejtësisë në Kosovë. Parashtruesja përkatëse nuk kishte shterur mjetet juridike përkundër paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht, Gjykata, konstatoi se kërkesa e saj ishte e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike (shih rastin e Gjykatës, KI114/10, parashtruese *Vahide Badivuku*, Aktvendim për Papranueshmëri i 18 majit 2011, paragrafët 10-11 dhe 24-25).

67. Në rastin KI139/11, parashtruesi i kërkesës kontestoi kushtetutshmërinë e Njoftimit [Nr. 01/118-658] të 27 tetorit 2010 të KGJK-së për riemërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, me të cilin ai u njoftua se mandati i tij si gjyqtar në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, pushon nga po ajo datë. Në vlerësimin e Gjykatës, parashtruesi përkatës nuk kishte shteruar mjetet juridike përkundër kërkesave të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht, Gjykata, konstatoi se kërkesa e tij ishte e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike (shih rastin e Gjykatës, KI 139/11, parashtrues *Ali Latifi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 20 marsit 2012, paragrafët 11, 14-16, 19, 26-27).
68. Më tej, në rastin KI130/12, parashtruesi i kërkesës kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit [ZZVP/12/123] të 23 nëntorit 2012 të Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial. Parashtruesi i kërkesës kishte aplikuar për pozitën e prokurorit në Prokurorinë Komunale të Gjilanit dhe të Ferizajt dhe më 24 nëntor 2012, u njoftua nga Paneli Vlerësues i Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial se nuk ishte rekomanduar për pozitën që kishte aplikuar. Gjykata gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës iu referua dispozitave relevante të Ligjit nr.03/L-202 për Konflikt Administrativ (në tekstin e mëtejme: LKA), edhe në këtë rast vendosi se nuk janë shteruar mjetet juridike sepse parashtruesi përkatës nuk ka iniciuar konflikt administrativ, bazuar në legjislacionin në fuqi në Kosovë (shih, rastin e Gjykatës KI130/12 parashtrues *Xhymshit Xhymshiti*, Aktvendim për Papranueshmëri i 13 marsit 2013, paragrafët 11, 20, 22-23).
69. Në rastin KI145/15, parashtruesi i kërkesës kontestoi Vendimin [nr. 321/2015] e 5 nëntorit 2015 të KPK-së për shpalljen e vendeve të lira për zgjedhjen e anëtarit të shoqërisë civile në përbërjen e KPK-së, sepse parashtruesi i kërkesës ishte zgjedhur anëtar i KPK-së nga radhët e shoqërisë civile me një mandat 5 (pesë) vjeçar, por pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, u ndryshua procedura përmes së cilës zgjedhën 3 (tre) anëtarët nga radhët e shoqërisë civile, duke u përcaktuar se këta të fundit zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës dhe në këtë linjë, KPK-ja vendosi të shpallë konkursin për zgjedhjen e anëtarit jo-prokuror nga radhët e shoqërisë civile duke publikuar konkursin për këtë pozitë. Parashtruesi i kërkesës u ankua në gjykatat të rregullta dhe njëkohësisht parashtrroi kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht, pezullimin ose shtyrjen e procedurës për zgjedhjen e anëtarit të ri të KPK-së. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës u refuzua nga Gjykata Themelore dhe më pas ajo e Apelit, pasi konstatoi se ai nuk kishte paraqitur fakte dhe prova se ekzekutimi i vendimit të goditur me padi, të njëjtit do t'i sillte dëm, se dëmi vështirë do të riparohet dhe se shtyrja nuk ishte në kundërshtim me interesin publik. Parashtruesi i kërkesës rrjedhimisht në Gjykatë Kushtetuese u ankua për procedurat në Gjykatë Themelore, duke theksuar se ato zgjasim mesatarisht dy vite, andaj "*në rastin e parashtruesit të kërkesës për shkak të urgjencës së çështjes e bëjnë këtë mjet jo efektiv*". Gjykata në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës theksoi se parashtruesi përkatës është ende në pritje të vendimit për meritën në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe prandaj ai nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, përkatësisht

në rrethanat e rastit konkret, kërkesa e tij ishte e parakohshme. Gjykata në arsyetimin e saj, ndër të tjerash, kishte theksuar se kohëzgjatja e procedurave, në vetvete, nuk e bën joefektiv mjetin juridik (shih rastin e Gjykatës, KI 145/15 parashtrues *Florent Muçaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 14 marsit 2016, paragrafët 12-20, 31-32, 34, 41).

70. Në rastin KI42/20, parashtruesi i kërkesës, i cili po ashtu është parashtrues i kërkesës së tanishme në rastin KI79/22, kontestonte Vendimin e KPK-së lidhur me procesin e emërimit të Kryeprokurorit në Prokurorinë Speciale të Republikës Kosovës, pozitivisht kjo në të cilën kishte aplikuar. Duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës KI99/14 dhe KI100/14 dhe Aktgjytimeve në rastet KI34/17 e KI55/17, të cilat Gjykata i kishte trajtuar edhe pse nuk ishin shteruar mjetet juridike, e të cilat raste do të sqarohen më poshtë, parashtruesi i kërkesës theksoi se nuk ka nevojë të shterohen mjetet juridike, para parashtrimit të kërkesës në Gjykatë Kushtetuese. Gjykata në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës theksoi se rasti i parashtruesit të kërkesës dallon dhe nuk është në mënyrë relevante i krahasueshëm me rastet KI99/14 dhe KI100/14, KI34/17 dhe KI55/17, duke dhënë arsyetim të detajuar përse parashtruesit e kërkesave në ato raste janë liruar nga obligimi për shterim të mjeteve juridike dhe duke theksuar se përveç mundësisë së kundërshtimit të procesit të përzgjedhjes të Kryeprokurorit të PSRK-së në kuadër të KPK-së, ligjet e aplikueshme u referohen edhe mjeteve tjera juridike të përcaktuara përmes LKA-së. Rrjedhimisht kërkesa e parashtruesit të kërkesës u shpall e papranueshme si rezultat i mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj (shih rastin e Gjykatës, KI 42/20 parashtrues *Armend Hamiti*, Aktvendim për Papranueshmëri i 29 korrikut 2020, paragrafët 10-15, 26,52-53 dhe 63).
71. Më tej, në rastin KI43/20, parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të KPK-së, pasi e njëjta kishte aplikuar në pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Parashtruesja e kërkesës nuk ishte propozuar si kandidat i KPK-së që do të shkojë në procedurën e mëtutjeshme të votimit për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Andaj, pranë Gjykatës Kushtetuese, ajo pretendoi se nuk është e nevojshme të shterohet mjetet juridike duke iu referuar Aktgjykimit në rastet KI99/14 dhe KI100/14 dhe Aktgjytimeve në rastet KI34/17 e KI55/17. Gjykata në vlerësimin e kushtetutshmërisë së kërkesës theksoi se parashtruesja e kërkesës, pas marrjes së vendimeve të KPK-së, drejtpërdrejtë iu drejtua Gjykatës Kushtetuese, pa shteruar mjetet juridike të përcaktuara në procedurë administrative. Rrjedhimisht, Gjykata shpalli kërkesën e saj të papranueshme (shih rastin e Gjykatës, KI 42/20 parashtruese *Fitore Sadikaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 29 korrikut 2020, paragrafët 9, 15, 23-24, 44 dhe 48).
72. Në fund, në rastin KI164/20, parashtruesi i kërkesës kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimeve të KGJK-së në lidhje me procesin e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi parashtruesi i kërkesës kishte aplikuar për këtë pozitë por ai nuk ishte rekomanduar për gjyqtar. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se dispozitat e Ligjit për KGJK-së, nuk parashohin mjete juridike kundër vendimit të kontestuar dhe gjithashtu iu referua Aktgjytimeve të Gjykatës në rastet KI99/14, KI100/14 dhe KI34/17 e KI55/17. Gjykata Kushtetuese, ndër të tjerash, theksoi se, përveç mundësisë së kundërshtimit të procesit të përzgjedhjes së gjyqtarëve në kuadër të KGJK-së, ligjet e aplikueshme u referohen edhe mjeteve tjera juridike të përcaktuara përmes LKA-së. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës u shpall e papranueshme sepse nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj (shih rastin e Gjykatës, KI 164/20, parashtrues *Rafet Haxhaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 20 janarit 2021, paragrafët 17, 25, 50-51).

73. Gjykata gjithashtu thekson se përpos kërkesave për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve apo njoftimeve të institucioneve të drejtësisë, ajo po ashtu ka trajtuar raste kur para saj janë kontestuar vendimet e ndryshme të Kuvendit apo Qeverisë dhe të cilat ishin kontestuar para Gjykatës, sigurisht përmes kontrollit individual, pa i shteruar mjetet juridike të përcaktuara në ligj apo edhe pa argumentuar para Gjykatës se të njëjtat nuk ishin "efektive" bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në rrethanat e rasteve përkatëse. Për shembull, në rastin e Gjykatës KI147/18, me parashtrues *Arbër Hadri*, Aktvendim për Papranueshmëri i 11 tetorit 2019, ishin kontestuar proceduarat përkitazi me përzgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, përkatësisht Vendimi [06/375] i 22 majit 2018 të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor të Kuvendit për rekomandimin e kandidatëve për përzgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës si dhe Vendimi [Nr. 06-V-151] i 6 qershorit 2018 i Kuvendit për përzgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë së lartcekur. Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit përkatës, Gjykata kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës përtej mundësisë së kontestimit të procedurave përkitazi me përzgjedhjen e Drejtorit të Agjencisë brenda Kuvendit, nuk kishte ushtruar mjetet tjera juridike të përcaktuara përmes LKA-së dhe Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, respektivisht dhe për pasojë, e kishte deklaruar kërkesën e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme për faktin se nuk ishin shteruar mjetet juridike të parapara me ligj dhe për faktin se nuk kishin plotësuar kushtet për të liruar parashtruesin e kërkesës nga detyrimi për të shteruar mjetet juridike (shih, rastin KI147/18, cituar më lart, paragrafët 53 dhe 61).
74. Një qasje të njëjtë, Gjykata kishte mbajtur edhe në rastin KI211/19, ku ishte kontestuar Vendimi [nr.11/111] i Qeverisë së Republikës së Kosovës i 19 korrikut 2019, që ndërlidhej me Vendimin e Qeverisë [nr.05/55] për kthimin e pronave shoqërore komunave të Kosovës. Në këtë kontekst, Gjykata kishte vlerësuar se Vendimet e kontestuara të Qeverisë mund të kontestohen në procedurë administrative bazuar në dispozitat e LKA-së dhe se parashtruesit e kërkesës kishin dështuar që t'i shfrytëzojnë mjetet juridike të parapara përmes LKA-së dhe gjithashtu kishin dështuar të argumentojnë para Gjykatës, se të njëjtat nuk do të ishin mjete juridike "efektive", bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, në rrethanat e rastit përkatës (shih, rastin e Gjykatës, KI211/19, cituar më lart, paragrafët 62 dhe 80).
75. Për më tepër, Gjykata ka refuzuar si të papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike edhe raste në të cilat kërkesa për lirim nga ky detyrim është bazuar, ndër tjerash, në "rrethana të veçanta" të një parashtruesi, duke përfshirë "kontekstin ligjor dhe politik" siç është rasti KI108/18 (shih rastin e Gjykatës, KI108/18, me parashtruese *Blerta Morina*, Aktvendim për Papranueshmëri i, 30 shtatorit 2019, paragrafët 148 deri më 193 dhe referencat e përdorura aty).
- (b) *Rastet ku Gjykata ka vendosur që rastet janë të pranueshme përkundër faktit që parashtruesit e kërkesës nuk kishin shterur mjetet juridike para se t'i drejtoheshin Gjykatës*
76. Tri përjashtimet e para, në të cilat parashtruesit përkatës janë liruar nga ky detyrim, përkatësisht rastet e Gjykatës KI56/09, KI06/10 dhe KI41/12, reflektojnë rrethana të cilat nuk ndërlidhen në asnjë mënyrë me rrethanat e rastit konkret. Ndërsa, përkitazi me tri Aktgjykimet tjera, përkatësisht KI99/14 dhe KI100/14 (raste të bashkuara); KI34/17; dhe KI55/17 dhe të cilat ndërlidhen me kontestimin e akteve të autoriteteve publike përmes të

cilave janë përzgjedhur/propozuar/emëruar kandidatë të ndryshëm në funksioneve shtetërore, Gjykata fillimisht rikujton se në rastet e bashkuara KI99/14 dhe 110/14, parashtruesit përkatës kontestonin procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit. Më specifikisht, parashtruesi në kërkesën KI99/14, kontestoi Vendimin [KPK nr. 151/2014] e 6 qershorit 2014 të KPK-së për emërimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit, ndërsa parashtruesja në kërkesën KI100/14, kontestoi Vendimin [KPK/146/2014] e 5 qershorit 2014, lidhur me kërkesën e saj për rishqyrtimin e listës përfundimtare me pikët e vlerësimit të kandidatëve. Duke liruuar parashtruesit përkatës nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike, Gjykata, ndër tjerash, theksoi se dispozitat e ligjit në fuqi për KPK-në nuk parashohin mjete juridike por, edhe në qoftë se ka mjete juridike, në rastin e parashtruesve nuk janë dëshmuar si efikase, për më tepër Gjykata theksoi, “*specificitetin e procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, Gjykata është e mendimit që nuk ka mjete juridike për shterim.*” (shih rastet KI99/14 dhe KI100/14, cituar më lart, paragrafët 48, 50, 52-53, 54). Në këtë rast, Gjykata konstatoi shkelje të Kushtetutës përkritazi me procesin e zgjedhjes, përkatësisht propozimit të kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit, duke urdhëruar përsëritjen e procedurës përkatëse.

77. Ngjashëm, në dy Aktgjykime tjera, përkatësisht, KI34/17 dhe KI55/17, parashtrueset përkatëse kërkuan vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve për zgjedhjen e Kryetarëve të Gjykatës Supreme dhe të Apelit, respektivisht. Më saktësisht, parashtruesja në rastin KI34/17, kërkoj vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit [KGJK nr. 50/2017] të 6 marsit 2017 të KGJK-së, përmes të cilit Kryetar i Gjykatës Supreme u zgjodh një kandidat tjetër dhe jo parashtruesja e kërkesës, ndërsa parashtruesja në rastin KI55/17, kërkoj vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit [KGJ nr. 13/2017] të 13 janarit 2017 të KGJK-së, përmes të cilit Kryetar i Gjykatës së Apelit u zgjodh një kandidat tjetër dhe jo parashtruesja e kërkesës
78. Të dy parashtrueset paraqitën kërkesat respektive në Gjykatën Kushtetuese, pa shteruar mjetet juridike të përcaktuara në ligj, duke u referuar në praktikën e Gjykatës në rastet KI99/14 dhe KI100/14. KGJK, në përgjigjen e saj, kishte theksuar se parashtrueset e kërkesës kanë mundur të iniciojnë konflikt administrativ dhe të përdorin mjetet juridike në dispozicion sipas LKA-së. Megjithatë, Gjykata, në të dy rastet, vendosi që duke marrë parasysh specifikën e procedurës së zgjedhjeve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të Apelit, respektivisht dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, nuk ka mjet juridik që adreson në mënyrë efektive pretendimet e ngritura nga parashtrueset e kërkesës (shih, rastin KI34/17 cituar më lart, paragrafët 28,-29, 42, 70, 73; dhe rastin KI55/17 cituar më lart, paragrafët 24, 31, 53, 55, 58). Në të dy rastet, Gjykata konstatoi shkelje të Kushtetutës përkritazi me procesin e zgjedhjes së Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe të Apelit, duke urdhëruar përsëritjen e procedurave përkatëse.

(ii) *Opinionet dhe raportet e Komisionit të Venecias dhe analizë krahasimore përkritazi me shterimin e mjeteve juridike*

79. Në kontekst të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do t'i referohet edhe dokumenteve të miratuara dhe publikuara nga Komisioni Venecias si në vijim: (i) Dokumentit [CDL-PI(2020)004, i 14 prillit 2020] të Komisionit të Venecias që përmban përmbledhjen e opinioneve, raporteve dhe studimeve përkritazi me drejtësinë kushtetuese; (ii) Studimit [nr. [38/2009, i publikuar më 27 janar 2011] përkritazi me qasjen individuale në drejtësinë kushtetuese, miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e saj plenare të 85-të (17-18 dhjetor 2010); dhe (iii)

Raportit të ndryshuar [CDL-AD(2021)001] përkitazi me qasjen individuale në drejtësi kushtetuese, i miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e saj plenare të 125-të (11-12 dhjetor 2020).

80. Gjykata fillimisht vëren se në konkluzionet e Studimit përkitazi me qasjen individuale në drejtësinë kushtetuese [nr.38/2009], përkatësisht në paragrafin 150 të tij, theksohet se:

“150. [...] Së pesti, për të siguruar efektivitetin e qasjes individuale në drejtësinë kushtetuese, palët duhet të veprojnë në mirëbesim, duke shmangur kërkesat abuzive dhe duke vepruar vetëm pasi të jenë shteruar mjetet e tjera të mundshme juridike. Shterimi i mjeteve juridike është i nevojshëm në vendet me kontroll të përqendruar të kushtetutshmërisë për të shmangur mbingarkesën e gjykatës kushtetuese. Së gjashti, duhet të sigurohet që mjete juridik në dispozicion është i përshtatshëm për të zgjidhur ankesën e parashtruesit të kërkesës. Ndër parimet procedurale të zbatueshme për vlerësimin e kushtetutshmërisë, ekzistojnë sisteme kontradiktore, në të cilat palëve në procedurën e mëparshme u jepet mundësia të paraqesin pikëpamjet e tyre. Gjykata Kushtetuese gjithashtu duhet të jetë në gjendje të miratojë vendimin e saj në kohën e duhur dhe pa vonesa të panevojshme; respektimi i afateve të sakta kohore nuk duhet të lejohet të rrezikojë efektivitetin e procedurës.”

81. Përderisa Raporti i ndryshuar [Nr. 1004/2020] përkitazi me qasjen individuale në drejtësi kushtetuese, i miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e saj plenare të 125-të (11-12 dhjetor 2020) i publikuar më 22 shkurt 2021, paraqet një analizë krahasimore të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës përkitazi me detyrimin për shterimin e mjeteve juridike, e reflektuar në paragrafët 86-88 të këtij Raporti si në vijim:

“86. Në mënyrë tipike, individi mund të bëjë një ankesë kushtetuese të plotë ose normative vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike (p.sh., Shqipëria, Andorra, Armenia, Azerbajxhani, Brazili, Kroacia, Republika Çeke, Gjermania, Hungaria, Republika e Koresë, Letonia, Lihtenshtajni, Malta, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Zvicra dhe Turqia). Kështu, kompetencat e gjykatës kushtetuese janë të kufizuara nga parimi i subsidiaritetit, përkatësisht gjykata kushtetuese mund të vendosë për aktet e kontestuar vetëm pasi të gjitha instancat e gjykatave të rregullta janë deklaruar ose kur nuk është e mundur ankesa në një gjykatë të rregullt [duke iu referuar, përmbledhjes Amicus curiae për Gjykatën Kushtetuese të Gjeorgjisë mbi efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në vendimet përfundimtare në çështjet civile dhe administrative, paragrafi 26]. Shterimi i mjeteve juridike mund të ketë kuptime të ndryshme në dritën e kontekstit specifik ligjor vendas.

87. Parakushti i shterimit për ngritjen e një anekese kushtetuese ekziston vetëm në vendet me sisteme të përqendruara të vlerësimit. Në vendet me shqyrtim të përhapur, një individ mund të kontestojë një akt individual ose normativ për shkak të shkeljes së kushtetutës në çdo fazë të procedurës.

88. Në rastet kur kërkesa e shterimit të të gjitha mjeteve juridike mund të shkakttojë dëme të pariparueshme për individin, zakonisht nuk kërkohet shterimi i mjeteve juridike (p.sh., Austri, Azerbajxhan, Kroaci, Republika Çeke, Gjermani, Letoni, Mal të Zi, Sllovaki, Slloveni dhe Zvicër). Komisioni i Venecias vlerëson se një përjashtim nga kërkesa për shterimin e mjeteve juridike duhet të parashikohet për të gjitha rastet kur respektimi i këtij rregulli mund të shkakttojë dëme të pariparueshme për individin.”

82. Në vijim, në po të njëjtin Raport të lartcekur të Komisionit të Venecias, është elaboruar edhe çështja e parimit apo karakterit subsidiar të GJEDNJ-së në lidhje me detyrimin për shterimin e mjeteve juridike. Paragrafët 198-199 të këtij dokumenti theksojnë se:

198. Kompetencat e GJEDNJ-së janë të kufizuara nga parimi i subsidiaritetit. Kjo do të thotë, ajo mund të vendosë lidhur me aktin e kontestuar vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha instancat e sistemit ligjor vendas. Deklarata e Interlakenit, e cila insiston në natyrën subsidiare të mekanizmit të Konventës: “4. Konferenca rikujton se është përgjegjësi para së gjithash e shteteve palë të garantojnë aplikimin dhe zbatimin e Konventës dhe rrjedhimisht u bën thirrje shteteve palë që të angazhohen që: ... d) të sigurojnë, nëse është e nevojshme, duke futur mjete të reja juridike, qofshin ato të një karakteri specifik apo të përgjithshëm, se çdo person me një pretendim të diskutueshëm se të drejtat dhe liritë e tij të përcaktuara në Konventë janë shkelur, ka në dispozicion një mjet juridik efektiv përpara një autoriteti kombëtar që ofron kompensim adekuat aty ku është e përshtatshme;

199. Përveç kësaj, Protokolli nr. 15 (ende jo në fuqi) për ndryshimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjithashtu i referohet parimit të subsidiaritetit në nenin 1 që ndryshon parathënien në preambulën e Konventës si më poshtë: “Duke pohuar se Palët e Larta Kontraktuese, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, kanë përgjegjësinë kryesore për të siguruar të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë dhe në Protokollet e saj, dhe që duke vepruar kështu ata gëzojnë një hapësirë vlerësimi, duke iu nënshtruar juridiksionit mbikëqyrës të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut të përcaktuar me këtë Konventë”.

83. Përderisa Dokumenti i Komisionit të Venecias që përfshin përmbledhjen e opinioneve, raporteve dhe studimeve përkitazi me drejtësinë kushtetuese [CDL-PI(2020)004, i 14 prillit 2020] në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike i referohet:

(i) paragrafit 26 të përgjigjes *Amicus Curiae* CDL-AD(2018)012 të Komisionit të Venecias për Gjykatën Kushtetuese të Gjeorgjisë, përkitazi me efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me vendimet finale në çështje civile dhe ato administrative, i cili specifikon se: “5.2.3 Shterimi i mjeteve juridike “Individi mund të ngrejë procedurë të plotë ankimore individuale kushtetuese vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike. Pra, kompetencat e gjykatës kushtetuese kufizohen nga parimi i subsidiaritetit, përkatësisht, gjykata kushtetuese mund të vendosë për aktet e kontestuara vetëm pasi të gjitha instancat e gjykatave të rregullta të jenë deklaruar ose kur nuk është e mundur ankesa në një gjykatë të rregullt.”; (ii) paragrafit 9 të Opinionit të Komisionit të Venecias në Draft-Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Azerbajxhanit, ku theksohet se: “Neni 33 zgjidh çështjet që u ngritën në opinionin e përkohshëm: • Gjykata Kushtetuese mund të pranojë ankesa edhe pa shterimin e mjeteve të tjera, nëse këto mjete nuk mund të parandalojnë dëmin e riparueshëm për ankuesin”; (iii) paragrafit 50 të Opinionit [CDL-AD(2008)03 për Draft-Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi, ku theksohet se: “Mund të ketë mjete të rregullta juridike, të cilat janë të përcaktuara me ligj, por që janë joefektive, sepse mund të mos jenë të përshtatshme për të shmangur pasoja të dëmshme të pakthyeshme për parashtruesin e kërkesës në dritën e jurisprudencës së vazhdueshme të gjykatave të rregullta. Në raste të tilla të rralla dhe të jashtëzakonshme, Gjykata Kushtetuese duhet të ketë mundësinë të pranojë ankesa individuale edhe para shterimit të këtyre mjeteve juridike joefektive.”; (iv) paragrafit 54(4) të Opinionit [CDL-AD(201) Ligjin e Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë: “Përrjashtimi nga kërkesa për shterimin e mjeteve juridike duhet të parashikohet për të gjitha rastet kur respektimi i këtij rregulli

mund të shkaktojë dëme të pariparueshme për individin.”; dhe (v) paragrafit 32 të Opinionit [CDL-AD(2015)027] përkitazi me amendamentet e propozuara në Kushtetutën e Ukrainës për gjyqësorin, ku është nënvizuar se: “Opinionit paraprak rekomandoi të sqarohej se një ankesë kushtetuese mund të parashtrohet vetëm “pas shterimit të mjeteve të brendshme juridike”. Kjo është bërë tani në amendamentet e rishikuara dhe është për t’u përshëndetur.”

II. Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rasteve konkrete

84. Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata, siç ka sqaruar tashmë përmes praktikës së saj gjyqësore, fillimisht thekson se nuk ka një të drejtë të fituar për lirin nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike. Shterimi i mjeteve juridike është një detyrim kushtetues, i përcaktuar qartë përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës. Për më tepër, një rregullim i tillë, është në përputhje me praktikën e drejtësisë kushtetuese në shtete me kontroll të centralizuar kushtetues, siç është sqaruar përgjatë shtjellimit të parimeve të përgjithshme më lart. Sigurisht që bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, GJEDNJ-së dhe analizës krahasimore të përmbledhur nga Opinionet e Komisionit të Venecias, mund të ketë përjashtime nga ky rregull dhe një vlerësim i tillë, nuk duhet t’i nënshtrohet një qasjeje të tepruar formaliste. Thënë këtë, në aplikimin e këtij përjashtimi, duhet të plotësohen kriteret e përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe një vlerësim i tillë bëhen nga rasti në rast. Një qasje të tillë e ndjek edhe GJEDNJ-ja, siç është sqaruar më lart, e cila aplikon parimet përkatëse në dritën e rrethanave të veçanta të secilit rast veç e veç, duke mos rezultuar gjithnjë në konkluzione të njëjta nëse në një rast të caktuar janë shteruar mjetet juridike ose jo. Pra, një konstatim i tillë varet nga specifikat e secilit rast dhe aplikimit të kriterëve të caktuara përmes praktikës së saj gjyqësore në secilin rast individual (shih rastin e Gjykatës [KI57/22](#) dhe [KI79/22](#), parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, Aktvendim për papranueshmëri i 4 korrikut 2022, paragrafi 103).
85. Siç është sqaruar përmes praktikës gjyqësore, bazuar në parimin e subsidiaritetit, qëllimi dhe arsytimi i detyrimit për të shteruar mjetet juridike ose rregulli i shterimit, është t’u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ai bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 të Kushtetutës dhe në nenin 13 të KEDNJ-së, se rendi juridik i Republikës së Kosovës siguron mjete efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së *Weis kundër Sllovenisë*, nr.37169/03, Vendim i 14 shkurtit 2012; dhe *Aksoy kundër Turqisë*, nr. 21987/93, Aktgjykimi i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51).
86. Gjykata në vazhdimësi e respekton parimin e subsidiaritetit, duke konsideruar se të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat para gjykatave të rregullta, me qëllim që të parandalojnë shkeljen e Kushtetutës ose, nëse ka, të korrigjojnë shkeljen e tillë të një të drejte themelore të garantuar me Kushtetutë. Gjykata po ashtu ka pohuar në vazhdimësi se parashtruesit e kërkesës janë përgjegjës kur rastet e tyre përkatëse shpallen të papranueshme nga Gjykata, nëse nuk kanë shfrytëzuar procedurën e rregullt ose nuk kanë raportuar shkelje të Kushtetutës në procedurat e rregullta (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: *KI89/15*, parashtrues *Fatmir Koçi*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 marsit 2016, paragrafi 35; dhe shih, gjithashtu, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë*, nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, Aktgjykimi i 25 marsit 2014, paragrafi 70).

87. Bazuar në të njëjtën praktikë gjyqësore, lirimi nga detyrimi për të shteruar mjetet juridike, bëhet vetëm përjashtimisht dhe vetëm në raste specifike me rastin e analizimit të këtij kriteri të pranueshmërisë në dritën e rrethanave faktike, juridike dhe praktike të një rasti konkret (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës në të cilat është aplikuar një përjashtim i tillë: KI56/09, parashtrues *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2010, paragrafët 44-46; KI06/10, parashtrues *Valon Bislimi*, Aktgjykim i 30 tetorit 2010, paragrafët 50-56 dhe paragrafi 60; KI41/12, parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim i 25 janarit 2013, paragrafët 64-74; KI99/14 dhe KI100/14, cituar më lart, paragrafët 47-50; KI34/17, parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 68-73; dhe KI55/17, parashtrues *Tonka Berisha*, Aktgjykim i 5 korrikut 2017, paragrafët 53-58).
88. Gjykata edhe një herë rikujton se, përgjatë gjithë praktikës së saj gjyqësore, që nga themelimi i saj, Gjykata ka bërë përjashtim nga shterimi i mjeteve juridike vetëm në gjashtë (6) raste, përkatësisht (i) KI56/09, parashtrues *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2010; (ii) KI06/10, parashtrues *Valon Bislimi*, Aktgjykim i 30 tetorit 2010; (iii) KI41/12, parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim i 25 janarit 2013; (iv) KI99/14 dhe KI100/14, parashtrues *Shyqri Syla dhe Laura Pula*, Aktgjykim i 3 korrikut 2014; (v) KI34/17, parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017; dhe (vi) KI55/17, parashtruese *Tonka Berisha*, Aktgjykim i 5 korrikut 2017. Tri Aktgjykimet e fundit, ndërlihen me kontestimin e procedurave për zgjedhjen, përkatësisht propozimin për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, në vitin 2014 dhe propozimin për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit, respektivisht, në vitin 2017. Që nga ky i fundit, praktika gjyqësore e Gjykatës nuk ka asnjë përjashtim në kuptim të detyrimit të shterimit të mjeteve juridike, siç përcakton paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës.
89. Gjykata rithekson se “*veprimet e organeve të administratës publike*”, mund të kontestohen në procedurë administrative, siç është përcaktuar në nenin 2 (Qëllimi) të LKA-së. Të njëjtat, bazuar në paragrafin 1.1 të nenit 3 (Përkufizimet) të LKA-së, përfshijnë edhe organet e qeverisjes qendrore, për më tepër që, bazuar në paragrafin 1.2 të të njëjtit nen, si akt administrativ kualifikohet çdo vendim, përfshirë atë të qeverisjes qendrore, i cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërisht, liritë ose interesat e personave fizik ose juridik.
90. Për më tepër, nenet 10 [pa titull] dhe 13 (Konflikti Administrativ) të LKA-së, ndër të tjera, përcaktojnë mundësinë e inicimit të konfliktit administrativ kundër akteve administrative për të cilat personi fizik apo juridik konsideron se i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor. Të njëjtën të drejtë, bazuar në nenin 18 [pa titull] të LKA-së, e kanë edhe organi i administratës, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike.
91. Gjithashtu, neni 63 (Dispozita të tjera të procedurës) i LKA-së, saktëson që në mungesë të dispozitave përkatëse të procedurës së konfliktit administrativ, përshtatshëmish zbatohen dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore. Ky i fundit, përkatësisht Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), ndër tjerash, në nenet 129 [Pa titull] dhe 130 [Pa titull], respektivisht, përcakton mundësinë e kthimit në gjendjen e mëparshme, në rast të humbjes së afateve për kryerjen e ndonjë veprimi procedural, nën kushtet e përcaktuara në këto nene.

92. Lidhur me të lartcekurat dhe nëse procedura lidhur me konfliktet administrative, do të ishte efektive për të zgjidhur rastin e parashtruesve të kërkesës, të paktën në teori, Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore, megjithëse në një kontekst tjetër, ku kishte ardhur në përfundim se *“Departamenti për Çështje Administrative ka juridiksion të plotë të shqyrtojë të gjitha çështjet e faktit dhe të ligjit që lidhen me kontestin para tij dhe të anulojë vendimin e Organeve të Kundërvajtjes në të gjitha aspektet, në çështjet e faktit dhe ligjit. Prandaj, Departamenti për Çështje Administrative, kualifikohet si një “organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë”, që i përmbushë kërkesat për t’u konsideruar si “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” në kuptim të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës.”* (shih rastin e Gjykatës KO12/17, parashtrues Avokati i Popullit, Aktgjykim i 9 majit 2017, paragrafi 97).
93. Gjykata më tej thekson se (i) përdorimi i mjeteve juridike në procedurë administrative për të kontestuar aktet e autoriteteve publike fillimisht në gjykatat e rregullta, gjithnjë sipas specifikave të ligjit të aplikueshëm, është rregull, ndërsa përjashtimet janë të mundshme vetëm nëse pala argumenton, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që një mjet i tillë, në rrethanat e rastit përkatës, nuk do të ishte efektiv. Për shembull, rasti i GJEDNJ-së, *Juričić kundër Kroacisë*, qartë saktëson që parashtruesja përkatëse, kandidatë për Gjykatën Kushtetuese Kroate dhe të cilën Kuvendi Kroat nuk e kishte zgjedhur, ishte detyruar që vendimin përkatës të Kuvendit së pari të kontestojë nëpër gjykata administrative dhe në fund, në Gjykatën Kushtetuese (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Juričić kundër Kroacisë*, nr.58222/09, Aktgjykim i 26 korrikut 2011); dhe (ii) në fakt, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së përcakton që është detyrë e individit të afektuar që të testojë efektivitetin e sistemit juridik dhe që të lejojë gjykatat e rregullta që të adresojnë pretendimet për shkelje të të drejtave përkatëse dhe t’i zhvillojë të njëjtat përmes fuqisë së interpretimit. Në të kundërtën, i njëjti, duhet të argumentojë, përmes barrës së provës, se kriteret e sqaruara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, plotësohen në atë mënyrë që do të duhej të rezultonin në lirimin nga detyrimi i shterimit të mjeteve juridike (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së *Gherghina kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 101).
94. Në këtë kontekst, përkitazi me rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson që (i) mjeti juridik ekziston; dhe (ii) që i njëjti është mjet efektiv juridik, përderisa parashtruesit e kërkesës nuk argumentojnë, duke përfshirë përmes praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta, se padia në procedurë administrative, nuk është në *“dispozicion dhe e qasshme”* ose nuk është *“mjaftueshëm e sigurtë jo vetëm në teori, por edhe në praktikë”* sepse nuk mund *“të ofrojë zgjidhje përkitazi me pretendimet e një parashtruesi”* dhe *“të ofrojë një mundësi të arsyeshme për sukses”*.
95. Në fakt, pretendimet kryesore të parashtruesve të kërkesës se përderisa nuk kanë pasur në dispozicion mjete juridike për të atakuar aktin e kontestuar, të njëjtit kërkojnë nga Gjykata që të konstatojë që *“parashtruesit e kësaj kërkesë kanë shterur mjete juridike dhe të vlerësojë shkeljen e të drejtave dhe lirive të tyre, me këtë kërkesë për vlerësim të ligjshmërisë.”* Ky argument, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së bie në kategorinë e *“dëshimeve të thjeshta”* për mungesën e efikasitetit të mjetit juridike dhe bazuar në të njëjtën, siç është sqaruar më lart, nuk vlen si arsye për ta liruar një parashtrues nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike të përcaktuara me Kushtetutë. Një qasje e tillë, bazuar në nenin 53 të Kushtetutës, është konsoliduar edhe nga Gjykata, ndër të tjera, përmes rastit KI108/18 (shih, rasti KI108/18, me parashtruese *Blerta Morina*, cituar më lart, paragrafët 183-187).

96. Për më tepër, Gjykata gjithashtu thekson se, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës duhet të argumentojnë që *“kanë bërë gjithçka që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga ata që të shterojë mjetet juridike”*. Në rrethanat e rastit konkret, ky nuk është rasti. Parashtruesit e kërkesës, nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim të vetëm për të kontestuar statutin në fjalë para gjykatave të rregullta, por në mënyrë të drejtpërdrejtë i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese.
97. Rrjedhimisht, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ta, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe mbi të gjitha duke u mbështetur në parimin e subsidiaritetit që tu ofrojë organeve kompetente, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës, konstaton se parashtruesit e kërkesës nuk i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë, pasi që nuk kanë shteruar mjetet juridike, siç është përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe si e tillë, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

98. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës theksojnë se caktimi i masës së përkohshme është i rëndësishëm sepse përveç cenimit të interesave private të tyre, këto interesa që lidhen me punën e tyre dhe të drejtën e tyre për të u zgjedhur, efekti i dëmshëm i këtij statuti shtrihet edhe në ndikimin publik duke qenë se ky statut cenon edhe interesat publike të cilat lidhen me ofrimin e shërbimeve mjekësore për qytetarë.
99. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se ajo tashmë ka konstatuar se kërkesat e parashtruesve të kërkesës lidhur me rastin, janë të papranueshme si rezultat i mosshterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj siç është përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit dhe me rregullin 57 (Vendimi për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme e parashtruesve të kërkesës, është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, refuzohet.

Kërkesa për mbajtje të seancës dëgjimore

100. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë kërkuar nga Gjykata që të mbajë seancë dëgjimore.
101. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në bazë të paragrafit 1 të rregullit 42 të Rregullores së punës, *“Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës, përveç nëse Gjykata, me shumicë votash, vendos ndryshe pas një arsytimi të mirë”*, ndërsa në bazë të paragrafit 2 të po të njëjtit rregull, *“Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit”*.
102. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Për më tepër, Gjykata thekson se, bazuar në rregullin e lartcekur, vetëm rastet të cilat shpallen të pranueshme dhe shqyrtohen meritat përkatëse mund të dëgjohen para Gjykatës përmes seancës dëgjimore. Rregullorja e punës i mundëson Gjykatës që përjashtimisht të bëjë një gjë të tillë edhe në raste kur një kërkesë nuk është e pranueshme, siç është rasti në

rrethanat e rastit konkret. Megjithatë, Gjykata rikujton që bazuar në paragrafin 2 të rregullit 42 të Rregullores së punës, ajo mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo beson se është e nevojshme për të qartësuar çështjet e provave apo ligjit. Në rrethanat e rastit konkret, ky nuk është rasti sepse Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth "provave apo ligjit" dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore. Dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur këtë rast (Shih rastin e Gjykatës: KI147/18, me parashtrues *Arbër Hadri*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 tetorit 2019, paragrafi 64).

103. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesve të kërkesës për mbajtje të seancës dëgjimore refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me pikën (b) të paragrafit 1 të rregullit 39, rregullin 42 dhe rregullin 57 të Rregullores së punës, më 12 prill 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme.
- III. TA REFUZOJË kërkesën për mbajtjen e seancës dëgjimore.
- IV. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- V. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VI. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani